

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Isa Kelmendi, kryetar, Erdogan Haxhibeqiri dhe Gyltene Sylejmani, anëtarë, në çështjen juridike të paditësve R. M. dhe P. M., të cilët i përfaqëson T.M. nga Komuna e Graçanicës, kundër të paditurës Qeveria e Kosovës me Seli në Prishtinë të cilën e përfaqëson Nazmije Aliu, për kompensim dëmi, duke vendosur përkitazi me revizionin e të autorizuarit të paditësve paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.2112/2015 datë 29.03.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 04.07.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i të autorizuarit të paditësve i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.2112/2015 datë 29.03.2018.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.2112/2015 datë 29.03.2018, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësve R. M. dhe P. M., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan C.nr.170/2013 datë 20.02.2015, vërtetohet me të cilin është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësve R. M. dhe P. M. nga Komuna e Lipjanit, me të cilën kanë kërkuar që e paditura Qeveria e Kosovës t'iu kompensojë dëmin paditëses R. M., shumën prej 6.524.50 €, në emër të dëmit material për 1\2 e të drejtës së pronësisë në shtëpinë që gjendej në fshati ..., në kohën e përfundimit të luftës dhe paditësit P. M. po ashtu shumën prej 6.524.50 €, për 1\2 e të drejtës së pronësisë në shtëpinë që gjendej në ..., dhe paditësit të dytë po ashtu shumën prej 5.076 €, në emër të dëmit të shkaktuar në objektet ndihmëse që i kishte në oborrin e shtëpisë të gjitha këto me kamatë ligjore sa paguajnë bankat komerciale për deponimet mbi 1 vit pa destinim të caktuar nga dita e aktgjykimit e deri te pagesa përfundimtare.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë në afatin ligjor paditësit kanë paraqitur revizion për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore

dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të dy aktgjykimet të ndryshohen dhe të aprovetet kërkesëpadia e paditësve ose të njëjtat të prishen dhe lënda të kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi aktgjykimin e goditur me revizion në kuptim të nenit 215 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), dhe gjeti se:

Revizioni i paditësve është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit kanë paraqitur padi kundër të paditurës për shpërblimin e dëmit të pësuar në shtëpitë e tyre dhe në objektet ndihmëse i cili dëm është shkaktuar pas përfundimit të luftës në Kosovë.

Gjykata e shkallës së parë vlerëson se Qeveria e Kosovës dhe institucionet e përkohshme që kanë qenë në Kosovë nuk mund të jenë përgjegjëse për dëmin e shkaktuar paditësve pasi që në anën e të paditurës mungon legjitimiteti pasiv për faktin se e paditura në fjalë nuk ka pas përgjegjësinë për sigurinë në Kosovë kur është shkaktuar dëmi duke iu referuar Rregullores së UNMIK-ut nr.1999/1 të datës 25.06.1999, si dhe Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë ku sipas nenit 6 dhe 8 të kësaj kornize si dhe Rregullores së UNMIK-ut nr.2000/45 përgjegjës për siguri në Kosovë ka qenë KFOR-i dhe UNMIK-u.

Gjykata e Apelit e Kosovës një vlerësim të tillë të gjykatës së shkallës së parë në tërësi e ka pranuar.

Gjykata Supreme e Kosovës duke pranuar në tërësi qëndrimin juridik të arsytimit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë konkludon se drejt është zbatuar e drejta materiale me rastin e refuzimit të ankesës e paditësve. Sipas Rezolutës të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244 e cila është miratuar me 10 qershor 1999, në pikën 7 autorizon shtetet anëtare dhe organizatat relevante ndërkombëtare për të vendosur një prani ndërkombëtare të sigurisë në Kosovë siç parashihet në pikën 4 aneksi 2 me të gjitha mjetet e nevojshme për të përmbushur përgjegjësitë e veta të parashtruara në paragrafin 9 të kësaj rezolute. Në bazë të paragrafit 9 të kësaj rezolute vendos që përgjegjësinë e pranisë ndërkombëtare të sigurisë që do të vendosin dhe do të veprojnë në Kosovë përveç tjerave nën pikën (d) të këtij paragrafi është garantimi i sigurisë dhe rendit publik derisa prania ndërkombëtare të marrë përgjegjësitë për këtë detyrë. Sipas paragrafit 10 autorizon Sekretarin e Përgjithshëm që me ndihmën e organizatave tjera relevante

ndërkombëtare ta krijojë një prani civile ndërkombëtare në Kosovë në mënyrë që të vendos një Administratë të Përkohshme për Kosovën dhe një Administratë Kalimtare dhe Mbikëqyrëse për Zhvillimin e Institucioneve të Përkohshme demokratike vetëqeverisëse për të siguruar kushtet për një jetë normale dhe të qetë për të gjithë banorët e Kosovës. Këto përgjegjësi të pranisë civile ndërkombëtare janë të përshkruara në pikën 11 të kësaj rezolute. Njëherit edhe me marrëveshjen teknike ushtarake të Kumanovës që është edhe pjesë e Rezolutës 1244 është përcaktuar nën nenin 1 dhe 2 se përgjegjësinë për sigurim dhe administrim civil në Kosovë do të marrin Kombet e Bashkuara dhe KFOR-i si forcë e sigurisë në Kosovë. Në bazë të Rregullores 2000/45 në nenin 1 është përcaktuar që deri në vendimin e Statusin e ardhshëm të Kosovës në pajtim të rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara themelohen institucionet e përkohshme për vet qeverisje autonome dhe demokratike në nivel komunal si hap drejt bartjes progresive të përgjegjësi të UNMIK-ut në Kosovë. Sipas paragrafit 1.2 Pushteti Qendror është i UNMIK-ut.

Nga të gjitha këto rezulton se përgjegjësinë për sigurinë në Kosovë në kohën kur është shkaktuar dëmi nuk ka pasur komuna si pushtet lokal ndaj të cilës është tërhequr padia por as Qeveria e Përkohshme e Kosovës me seli në Prishtinë. Prandaj Gjykata Supreme e Kosovës në tërësi pranon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë dhe të shkallës së dytë se ndaj KFOR-it dhe UNMIK-ut nuk ka jurisdikcion gjykata e rregullt në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr.2000/47 të datës 18.08.2000, për arsye se të njëjtat janë të liruara nga çfarëdo jurisdikcioni vendor. Prandaj të pabazuara janë pretendimet e revizionit të paditësve se përgjegjës për dëmin e shkaktuar paditësve kanë institucionet e përkohshme të qeverisjes në Kosovë nga arsyet të theksuara më lartë për këtë përgjegjësinë e ka pasur UNMIK-u dhe KFOR-i.

Nga arsyet e dhëna më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 222 të LPK.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Rev.nr.232/2018 datë 04.07.2018

Kryetar i kolegjit,

Isa Kelmendi